

Nr.regj. 16968/2010

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIE
AGENCY AGAINST CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. 03-99/12012
DPK/0112

12.03.2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË duke vendosur në procedurën e rivendosjes së çështjes kundërvajtëse kundër të pandehurit Hysni Veseli nga fshati Broboliq, Komuna Mitrovicë, 12.03.2012 për kundërvajtje nga neni 6 paragrafi 2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika I të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73,74, 195,199 dhe nenit 227 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë **02.03.2012** merr këtë:

AKTVE N D I M

I PANDEHURI: Hysni (Jetish) Veseli, i lindur 1968 në Mitrovicë, tani me vendbanim në fshatin Broboliq, Komuna Mitrovicë, i punësuar si Kryeshef Ekzekutiv në Ministrinë e Administratës Publike, i martuar, i gjendjes së mirë ekonomike,

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse, si zyrtar i lartë publik në pozitë të Kryeshefit Ekzekutiv në Ministrinë e Administratës Publike, nuk ka bërë deklarin e rregullt vjetor të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion, brenda afatit ligjor deri më datën 31.03.2010,

- me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 6.2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, andaj për këtë i shqiptohet,

D Ë N I M I

Me gjobë në shumë prej **300 € (trqind euro)**, të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formë e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së No.1000 4300 7000 0518. PAGESA bëhet në ndonjë agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **20 ditësh**, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgimi. Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej **10 Euro** në shërbimin e arkës së gjykatës. Nga një kopje e këtij aktvendimi ti dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtrroi kësaj gjykate kërkesën 01/2298/2010 me datë 15.06.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, meqë i njëjti nuk e ka dorëzuar në Agjencinë Kundër Korrupsion formularin mbi deklarin e gjendjes së pasurisë deri më datën 31 mars të 2010. Duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje, gjyqtarja në procedurën e rivendosjes ka bërë eliminimin e pakjartësisë që ka të bëjë me datën e shënuar në dispozitiv të aktvendimit të abroguar, të nxjerrë

03-934/200/02 sken

me datë 15.04.2011, ashtu që në vend të datës "31.03.2011" shënoi datën korrekte "31.03.2010", siç precizohet edhe në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në procedurën e rigjykimit, gjyqtarja gjithashtu dëgjoi të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet ritheksoi atë çfarë ishte pretendimi i tij ankimor, faktin se nuk ka bërë deklarinimin e pasurisë për shkak të angazhimeve zyrtare edhe jashtë vendit dhe se i kishte ikur nga mendja çështja e deklarinimit dhe e afatit për deklarinim, ndërsa vitin vijues siç thekson, e kishte deklaruar pasurinë me kohë.

Meqenëse, në procedurën e rigjykimit gjyqtarja nuk gjeti asnjë veprim kontestues, që kërkon të vërtetohet me prova të reja, rivendosi çështjen sërish duke vërtetuar gjendjen e njëjtë faktike, konstatoi se i pandehuri nuk ka respektuar dispozitën ligjore gjegjëse sipas së cilës ka qenë i obliguar të deklarojë pasurinë deri më 31.03.2010 dhe sërish mori aktvendim ndëshkues, të pandehurin e shpalli përgjegjës dhe i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor.

Gjatë shqiptimit të dënimit, gjyqtarja pati parasysht rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe duke vlerësuar peshën e kundërvajtjes, masën e shkeljes, shkallën e përgjegjësisë sipas pozitës së zyrtarit të lartë publik, të njëjtin e dënoi me gjobën e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se i pandehuri nuk do të përsëris vepër të tillë apo të ngjashme kundërvajtëse.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr.regj.16968/2010, datë 02.03.2012

Gjyqtarja
Suzana Çerkini



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh nga data e pramnit të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksë.